


NGA POPULLI



PËR POPULLIN

DEMOKRACIA - LIRIA E NJERIUT

ALBION (13), AGNESA B. (13), AGNESA C. (14), DIELLZA (13), ILIRIAN (14), ANDI (13)




Gazetarët japin mendimet e tyre në artikullin më poshtë

Demokracia është sistem i qeverisjes ku fjalën kryesore e ka populli. Ne mendojmë se demokracia është ndër sistemet më të mira të qeverisjes. Demokracia dallon nga sistemet e tjera politike sepse në demokraci të gjithë kanë të drejtat e barabarta pa dallim gjinie, moshe, feje, race apo kombësie. Demokracia së pari filloi në Greqi (Athinë) në vitin 507 para erës sonë.

het në demokraci përfaqësuese parlamentare dhe demokraci përfaqësuese presidenciale. Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare, ku populli i Kosovës voton në zgjedhje qendrore duke i zgjedhur përfaqësuesit e tij, pra deputetët.

Në demokraci, elementet kryesore janë: paqja, respekti, toleranca, barazia, të drejtat themelore të njeriut. Disa nga të drejtat e njeriut janë: e drejta për të jetuar, e drejta për punësim, e drejta e të shprehurit, e drejta për identitet, e drejta për shkollim, e drejta për argëtim, etj.


Në Kosovë, Kushtetuta është akti më i lartë juridik. Ajo ndryshe quhet libri i ligjeve. Kushtetuta u miratua më 15 prill 2008, disa muaj pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, e cila ka ndodhur me datën 17 shkurt 2008. Kosova si shtet i ri demokratik ka nevojë për zhvillim ekonomik, kulturor, arsimor e shëndetësor, e ne si e ardhmja e këtij vendi do të mundohemi të kontribuojmë sa më shumë për zhvillimin e Kosovës tonë.



Vetë fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë pushtet. Domethënë, demokracia është pushtet i popullit. Demokracia ndahet në demokraci përfaqësuese dhe të drejtpërdrejtë. Demokracia e drejtpërdrejtë është ajo demokraci ku populli merr pjesë në vendime politike në mënyrë të drejtpërdrejtë. Demokracia përfaqësuese është kur populli merr vendime politike, por nëpërmjet përfaqësuesve të vet. Demokracia përfaqësuese nda-




Gazetarët e këtij artikulli




Parimet e demokracisë paraqitur përmes këtij vizatimi



Kuvendi, Qeveria dhe gjykatat



Vota ime, ndryshimi ynë



Tri pushtetet punojnë të pavarura, por janë të barabarta



Në demokraci jemi të gjithë të barabartë pa dallim gjinie

TË GJITHË PËR NJË VEND DEMOKRATIK

ENDRINA (13), BASHKIM (13), BLERON (14), ELESJA (13), DAFINA (13), TEUTA (14), KUSHTRIM (13)

Ky artikull na paraqet të drejtën e të folurit dhe të drejtën e zgjedhjes. Nëse i bashkojmë të gjitha këto të drejta ne kemi respekt dhe dashuri për popullin. Megjithatë, artikullin po e fillojmë me një fjalë të urtë: „Të gjithë për një dhe një për të gjithë“

Në demokraci ne kemi lirinë e të shprehurit dhe mënyrën e të zgjedhurit sipas dëshirës sonë. Të gjithë ne duhet të kemi të drejtat tona të barabarta, por ne i kemi edhe detyrat dhe përgjegjësitë.

Përgjegjësitë janë obligime, të cilat ne duhet t'i kryejmë me rregull. Kurse veprimet të cilat ne i bëjmë tregojnë se çfarë karakteristika gjenden brenda nesh.

Çdo liri duhet të ketë një kufi dhe kjo liri duhet të mos keqpërdoret, ngaqë ne jetojmë në shekullin XXI kur demokracia është tejet e zhvilluar.

Shpesh herë në shkollë përmendim të drejtën e të shprehurit dhe të drejtën e zgjedhjes, mirëpo pa i respektuar ato nuk mund të kemi marrëveshje mes vete. Me zgjedhje mund të kuptojmë zgjedhjet mes gjërave të përditshme dhe zgjedhjet politike. Me zgjedhje të përditshme kuptojmë zgjedhjet e lira që ndodhin gjatë jetës së përditshme. Ne kemi të drejtë të zgjedhim çfarëdo ushqimi që preferojmë, ndërsa me zgjedhjet politike kuptojmë që populli zgjedh përfaqësuesit e vet.

Më herët kishin të drejtë të votonin vetëm burrat dhe të pasurit, kurse tani mund të votojë i gjithë populli mbi moshën 18 vjeçare.


Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik, ku vota e secilit qytetar ka vlerë. Pra, ne jetojmë në një shtet ku tani të gjithë kemi të drejtat tona të barabarta. Ndërsa, detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i kemi ndikojnë thellë në karakterin tonë.



Autorët e artikullit



Puna në grup



Në këtë figurë paraqitet mënyra e votimit e që është votim i mbyllur




Një qytetar duke shprehur mendimet e veta për të drejtëb e votimit, zgjedhjet dhe detyrat e tij si qytetar

ROLI I DEMOKRACISË

BLEON (14), EDONA (13), FJOLLA (13), BLERTA (13), ELSA (14), RILIND (13), RINOR (13)


NDARJA E PUSHTETIT



Ndarja e pushtetit në një shtet demokratik

Ndarja e detyrave ka një rol shumë të madh në jetën e përditshme. Për shembull, nëse në klasë secili i kryejmë detyrat tona, klasa do të funksiononte edhe më mirë. Edhe shteti funksionon shumë mirë kur bëhet ndarja e detyrave. Për këtë arsye ndarja e pushtetit në Republikën e Kosovës bëhet në tri degë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor. Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi, i cili merret me miratimin e ligjeve të cilat kanë ndikim të madh në jetën tonë. Në Pushtetin Ekzekutiv bën pjesë Qeveria, e cila merret me zbatimin e ligjeve të marra nga Kuvendi. Në Qeveri bën pjesë: Kryeministri, ministrat dhe zëvendësministrat. Në Pushtetin Gjyqësor bëjnë pjesë gjykatat, që sipas punëve që ato i kanë ndahen në: Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme.

Në këtë ndarje rolin kryesor e ka populli, sepse ai vetë i zgjedh përfaqësuesit të cilët do të punojnë për të mirën e popullit dhe të cilët do ta zgjedhin Qeverinë. Prandaj, është e rëndësishme të jetojmë në një shtet demokratik dhe të shprehim mendimin lirshëm, sepse të jetosh lirshëm është ëndërr e çdo individi.



Drejtësi për të gjithë popullin



Të gjithë jemi të barabartë



Bashkimi bën fuqinë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë